



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/90
Datë: 19.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen procesverbalet nga mbledhjet 85 dhe 86 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 02/90
Datë: 19.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave për negocimin e Marrëveshjes së Kredisë Eksportuese nr. 236.677 në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Unicredit Bank Austria AG, në lidhje me financimin e projektit "Krijimi i Qendrave e-testuese dhe përmirësimin e mëtutjeshëm të shërbimeve të e-Arsimit për arsimin para universitar në Kosovë".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/90
Datë: 19.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2019 Nr. 06/L -133, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet vendimi për rritjen e pensioneve në këto nën programe buxhetore: pensionet bazike-sociale me kod buxhetor 00100 rriten 20%, pensionet familjare me kod buxhetor 02900 rriten 20%, pensioni invalidor i punës me kod buxhetor 03000 rriten 20%, pensionet e parakohshme (Trepça) me kod buxhetor 00400 rriten 20% dhe pensionet kontribut dhënës me kod buxhetor 01200 rriten 15%.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1. të këtij vendimi implementohen nga ndarjet buxhetore të parapara me Ligjin Nr. 06/L-133 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2019, sipas nën programeve të cekura në pikën 1 të këtij vendimi, me efekt nga data 1 Janar 2019.
3. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/90
Datë: 19.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për kontrollin e tregtisë me mallra strategjike në këtë përbërje:
 - 1.1. Zana Kotorri / MTI - kryesuese;
 - 1.2. Behram Mazreku / MTI - zëvendës kryesues;
 - 1.3. Brahim Kokollari / MM - anëtar;
 - 1.4. Nazmi Zogaj / MM - zëvendës anëtar;
 - 1.5. Bujar Haxhidauti / DK - anëtar;
 - 1.6. Bujar Pefqeli / DK - zëvendës anëtar;
 - 1.7. Mensur Hoti / MPB anëtar;
 - 1.8. Driton Ademi / MPB zëvendës anëtar;
 - 1.9. Berat Jashari / MPJ - anëtar;
 - 1.10. Petrit Prekazi / MPJ - zëvendës anëtar;
2. Komisioni do të jetë përgjegjës për aprovimin, anulimin, ndryshimin dhe revokimin e licencave për eksport, import, transit, trans-ngarkim, ri-eksportim jashtë territorial, ri-transferim dhe për ofrimin e shërbimeve të ndërlydhura.
3. Komisioni do të përcaktojë Listën Shtetërore të Mallrave të Kontrolluara Strategjike.
4. Sipas nevojës dhe rrethanave, Komisioni mundë të kërkoj informata shtesë dhe ekspertizë prej institucioneve relevante të Republikës së Kosovës.
5. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për sigurimin e hapësirës dhe mbështetjes teknike për Komisionin.
6. Ky vendim shfuqizon Vendimin Nr. 16/61 të datës 22.08.2018.
7. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/90
Datë: 19.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Të realizohet Strategjia dhe Plani i Veprimit për Ndryshime Klimatike, 2019-2028/2019-2021.
2. Për realizimin e këtij dokumenti obligohen: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komunitat, KEK-u dhe institucionet tjera të përcaktuar në këtë dokument.
3. Ky dokument i cili del si kërkesë/obligim nga procesi i MSA dhe Traktati i Komunitetit të Energjisë, siguron kornizën që në mënyrë efektive zbutë shkaqet e ndryshimeve klimatike dhe në mënyrë efektive parashikon dhe i përgjigjet ndikimeve të ndryshimeve klimatike, duke marrë parasysh parimet ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm.

Komponenta për Zhvillim me Emetim të Ulët do të çojë në emetime më të ulëta të gazrave serrë sesa në skenarin e zakonshëm të punës. Ajo do të ndihmojë në:


1. Propozimin e zgjidhjeve prioritare për zbutje, të cilat do të sigurojnë mundësi ekonomike;
2. Identifikimin e pengesave për zhvillim ekonomik me emetim të ulët të karbonit;
3. Forcimin dhe mbështetjen në projektet/investimet ekzistuese, duke tërhequr mbështetje ndërkombëtare shtesë;
4. Vendimet që do të merren për kontributet/zotimet e ardhshme për zvogëlim sasior të emetimeve të gazrave serrë.

Komponenta për Zhvillim me Emetim të Ulët paraqet gjithsej 9 Masa të Duhura Kombëtare të Zbutjes të cilat maksimalizojnë përfitimet, duke minimizuar pasojat negative.

Komponenta e Përshtatjes do të përfshijë intervenime optimale, të cilat maksimalizojnë përfitimet duke minimizuar pasojat negative. Kjo komponentë përfshinë masat me kosto efektive, për zvogëlimin e rreziqeve, të cilat mund të realizohen pa komprometuar trajektoret e zhvillimit të qëndrueshëm dhe opsionet e përshtatjes të cilat sigurojnë përfitime pavarësisht kushteve të ardhshme klimatike.

4. Institucionet nga pika 2. e këtij vendimi kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Ndryshime Klimatike, 2017-2026/2017-2019, obligimeve nga procesi i MSA dhe Traktati i Komunitetit të Energjisë, Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 03/L-160 dhe ligjeve tjera në fuqi.
5. Arsyetimi i propozimit për Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Ndryshime Klimatike është dhënë në pikën 4^{te} të memorandumit shpjegues.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 06/90
Datë: 19.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 9, 10, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës Prishtinë - Pejë, Segmenti Kijevë - Klinë - Zahaq, zonat kadastrale: Kijevë, Komuna Malishevë, zonat kadastrale: Çabiq, Zabërgje, Gllarevë, Gjurgjevik, Dresnik, Dollc, Gremnik, Novosellë e Zajmit, Grabanicë, Drenoc, Potërq i Poshtëm, Potërq i Epërm, Komuna Klinë dhe zonat kadastrale Jabllanicë, Kliqinë, Leshan, Gllaviqicë dhe Ramun të Komunës së Pejës, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/90
Datë: 19.02.2019


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e MMPH-së, nr. prot. 699-2 datë 07.02.2019, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme (ish shoqërore) të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit "Renovimi dhe Ndërtimi i Objekteve për nevoja të "Selisë Qendrore të Federatës së Futbollit të Kosovës" (FFK), Zona kadastrale Prishtinë, Komuna Prishtinë, sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokollit 6308/18 datë 31.10.2018.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkuar dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkuar, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit përfundimtar, Federata e Futbollit të Kosovës (FFK), do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/90
Datë: 19.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Shërbimet Sociale dhe Familjare.
2. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/90
Datë: 19.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për miratimin në parim të Nismës për Marrëveshjen për "Projektin për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave drejt një shoqërie të shëndoshë, faza 2, Kërkesë për ndihmë të grantit për prokurimin e pajisjeve për menaxhimin e mbeturinave" në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Qeverisë së Japonisë.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 10/90
Datë: 19.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Organizues për manifestimin gjithë popullor për shënimin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili do të organizohet nën patronatin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, me datë 5, 6 dhe 7 mars 2019, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministri i Mbrojtjes - kryesues;
 - 1.2. Përfaqësues, Zyra e Kryeministrit, anëtar;
 - 1.3. Përfaqësues, Komuna Skenderaj, anëtar;
 - 1.4. Përfaqësues, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, anëtar;
 - 1.5. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Jashtme, anëtar;
 - 1.6. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar.
2. Ftohen që të dërgojnë nga një përfaqësues në Këshill Organizues:
 - 2.1. Zyra e Presidentit, anëtar;
 - 2.2. Kuvendi i Kosovës, anëtar;
 - 2.3. Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, anëtar;
 - 2.4. Asociacioni i Komunave të Kosovës, anëtar, dhe
 - 2.5. Përfaqësues të OJQ-ve.
3. Obligohet Këshilli Organizues dhe institucionet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë